**GAMeC NE SHQIP**

Galeria e artit modern dhe bashkekohor

Mireserdhet!

**DREJTIMI PER VIZITUESIT**

**Selia:**
Galeria e artit modern dhe bashkekohor, e peruruar ne 1991, si nje zgjerim i Akademise Carrara, e vendosur ne hapersirat e ish manastirit , te zene nen urdherin fetar te Servite dhe te Komunitetit te Dimesse, qe me pas do te emerohet si baze per sherbimet ushtarake deri ne momentin kur do te merret nga funksionet aktuale ne nje nderhyrje angazhuese per restaurim, e realizuar kjo ne bashkepunim me Bashkine e Bergamos dhe Kreditit Bergamask. Projekti i studios Gregotti te Milanos, ka percaktuar edhe dispozicionin urbanistik te kompleksit museal, nepermjet lidhjes se parashikuar me nje prej parqeve historike te nje relievi te madh, Parku Suardi, qe do te fitoje ne te gjithe kontekstin ambiental nje vlere te madhe, gjithashtu nje hapersire te ekspozites ne te hapur, pervec afrimit ne menyre te ndjeshme ne qendren e qyteterimit.

**Koleksioni i Perhershem** :

Koleksioni i perhershem i GAMeCit, i perbere nga vepra te artisteve italiane dhe te huaj te shekullit 20, i ofron vizituesit nje rruge te piktures, sckulptures fotografise, medalieve, vepra video, film kinematografik te dhuruara Akademise Carrara per Galerine e Artit modern dhe Bashkekohor nga artiste, koleksioniste dhe instituzione duke percaktuar nje prej traditave me te medha te qytetit.

Nje konsiderate te vecante meriton dhurata e artistit Giacomo Manzù (Bergamo 1908-Ardea, Roma 1991) e realizuar per qytetin e tij te lindjes ne fillim te viteve 80 qe pa asnje dyshim do te perfaqesoje zhvillimin artistik te skulptures europiane te viteve 900, qe me hapjen e GAMeCit ka gjetur nje lidhje ideale.
Kjo sfilate e veprave permban 2 skulptura monumentale (*Giulia dhe Mileto* 1966), Te dashuruarit (1971-1974) dhe nje seri veprash te vogla ne bronz si *Cardinali*, *Dashnoret* dhe *Hapat e Kercimit*. Gjithashtu e kompletojne kete koleksion disa piktura (*Autoportret* 1958) dhe vizatime te formateve te medha (*Giulia dhe Mileto* 1972). Nje tjeter veper e rendesishme e skulptorit qe eshte e pranishme ne kete koleksion fale kontributit te Bankes Popullore te Bergamos eshte *Busti i Pios* ne bronz ne 1950.
Ne te njejten menyre vullneti i Gianfranco Spajanit i dha nje kthese perfundimtare ketij koleksioni duke i dhuruar 40 piktura te mesuesve (mjeshter) italiane dhe te huaj te 900es, ne vecanti te gjysmes se pare te shekullit. Ne keto bejne pjese perfaqesuesit me te medhenj te piktures italiane si Umberto Boccioni, Giacomo Balla, Filipo De Pisis, Massimo Campigli, Mario Radice, Alberto Magnelli, Felice Casorati, Giorgio Morandi, Giorgio de Chirico, Alberto Savinio, Ennio Morlotti dhe Valerio Adami. Nje mjesh ter origjinal te ASTRATISMIT, Vasilij Kandinskij, jep shenjen e nje koleksioni nderkombetar qe perfshin vepra kuptimplote te Hartung, Matta, Hans Richter dhe Sutherland.
Se fundi dhurata e Gianfranco Stucchit, e realizuar ne 2004, qe do te zgjeroje kerkimet e para te astratismit ne Europe,e perfaqesuar kjo nga Atanasio Soldati, Alberto Magnelli dhe Luigi Veronesi. Paralelisht mund te gjenden ne Koleksionin Stucchi, mjeshterit e informales, si Alberto Burri dhe Tancredi Parmeggiani me eksperimente te stilit materiko, Anton Zoran Music qe konsideron maredhenjet ndermjet lindjes dhe perendimit, spanjoli Luis Feito perkthyes te nje pikture rafinuese, Jean Fautrier mjeshter i padiskutuar ne eksplorimin e fuqise shprehese te lendes.

Kompletojne gjithashtu panoramen nderkombetare Victor Pasmore, me nje forme paresore te prones organike dhe Ben Nicholson, krijues i shkelqyer i hapersires nepermjet formave te thjeshta. Nje hapje interesante bashkekohore do te jete ne fillim te viteve 90 nga Armando Maffeis qe do te sjelle ne kete koleksion 21 vepra te artisteve te rinj (midis tyre Maurizio Cattelan). Ne te njejten menyre jane shume kuptimplote dhuratat e viteve 90 te Lanfranco Colombo (450 fotografia te fotografeve italiane), te Cesare Johnson dhe Vittorio Lorioli (200 medalie dhe 100 modele per medalie) qe kane kontribuar hapjen e prospektivave te reja per kete koleksion.

**VIZITA SHOQERUESE**

Galeria e Artit Modern dhe Bashkekohor ofron per publikun vizita shoqeruese per shkolla, familje dhe te huaj me nje zgjatje rreth 1 ore. Eshte e mundur te kerkohet nje vizite shoqeruese ne gjuhet: anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjisht, portugeze, japoneze, arabe, persiane, rumanisht, shqip, hungareze, rusisht dhe çekosllovake.

**ORARI DHE TARIFA**

**HYRJA**

**Hyrja falas ne koleksionin e perhershem.**

**CMIMET E HYRJES NE MOSTREN E PERKOHESHME**

Normale: 7 euro
I Pakesuar: 5 euro, 2 euro shkolla
Hyrja eshte falas per te gjithe femijet nen moshen 6 vjeç, ndryshe nga te aftet dhe pensionistet.
Per grupet e te huajve jo banues ne Bergamo vizitat shoqeruese kane nje cmim prej 80 euro.

**ORARET E HYRJES**

**Koleksioni e perhershem**

10.00-13.00
15.00-19.00
Mbylle te henen

**Mostrat e Perkoheshme**

(te shikohet sitoja,sepse orari ndryshon ne baze te nevojes se cdo mostre)

**Ditet e vecanta te hapjes**

**BIBLIOTEKA**

Biblioteka e Akademise Carrara dhe e galerise se Artit Modern dhe Bashke kohor eshte e hapur ne zyrat ne rrugen S.Tomaso 53. Kjo pasuri permbledh rreth 12000 tituj te historise se artit dhe nje numer te konsideruar revistash te specializuara. Hyrja eshte falas. Biblioteka Antike (Giacomo Carrara) dhe Arkivi historik jane hapur publikut per keshillime. Jane ne dispozicion keto sherbime:
-Keshillime te librave me rafte hape publikut.
-Keshillime me perkrahjen e bibliotekarit.
-Kerkime ne online SBN.
-Sherbim fotokopie (me pagese)

**Orari i bibliotekes**
Nga e marte-te premte 14.30-18.30
Te shtune nga 9.00-13.00

**Takimet**:
Bibliotekaria: Maria Elisabetta Manca
Telefono: 035-235834
E-Mail: biblioteca.carrara@tiscali.it

**LEJA FIZIKE (PER PERSONA)**

Galeria e Artit Modern dhe Bashkekohor garanton nje sherbim te perhershem falas te vizitave shoqeruese per personat qe nuk shikojne, shurdhet dhe te gjithe ato qe jane te semure antikapate. Sherbimi eshte menduar i tille ne menyre qe te krijohet nje dialog krijues si per koleksionin e perhershem ashtu edhe per mostrat e perkoheshme. Te gjithe nivelet e Galerise jane te lejuara per publikun me nje kapacitet te pakesuar. Gjithashtu GAMeC ka ne dispozicion edhe disa sherbime si banjo, karrige me rrota per sakate etj.

**LEJA GJUHESORE**

Per te huajit banues ne territorin e Bergamos dhe rrethinave ekziston nje sherbim te vizitave shoqeruese me hyrje te lire te administruar nga ndermjetesit e muzeut, persona keto te formuar nga sherbimet edukative te GAMeCit per te lehtesuar viziten e atyre personave qe nuk njohin mire gjuhen italiane.

Per me shume informacione mund te kontaktoni ne nr 035-270272 nga e marte-te enjte nga ora 10.00.18.00.

Pergjegjese per sherbimin edukativ: Giovanna Brambilla Ranise
Giovanna.brambilla@gamec.it

**SI MUND TE ARRIHET NE GAMeC**

**Me autobus :**
Nga stacioni FS autobusi me nr 6, 7 ose 9.

**Me makine:**
Jane ne dispozicion falas vendqendrimet e stadiumit, pervec diteve te tregut-te shtuneve ne mengjes. dhe te dieleve kur jane ndeshjet sportive.
Nga stadiumi per ne GAMeC 5 minuta ne kembe ose duke marre autobusin 6, 7 ose 9.

**GAMec**
**Via S.Tommaso, 53**
**24122 Bergamo**
**Tel + 39 035270272-fax +390 35236962**
**www.gamec.it**

Pergatitur nga Julinda Doci (ndermjetese e muzeut ne GAMeC e gjuhes shqipe).